

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI FILOZOFIK**

**DEPARTAMENTI I HISTORISË**



**DIPLOMACIA NDËRKOMBËTARE DHE  
ÇËSHTJA E KOSOVËS 1997/1999**

**PUNIM I DOKTORATËS**

**Mentor:**

**Prof. dr. Agim ZOGAJ**

**Kandidat:**

**Mr. sc. Lulzim NIKA**

**Prishtinë, 2018**

**UNIVERSITY OF PRISHTINË “HASAN PRISHTINA”**

**FACULTY OF PHILOSOPHY**

**DEPARTMENT OF HISTORY**



**INTERNATIONAL DIPLOMACY  
AND THE KOSOVO ISSUES 1997/1999**

**Doctoral thesis**

**Mentor:**

**Prof. dr. Agim ZOGAJ**

**Candidate:**

**Mr. sc. Lulzim NIKA**

**Prishtinë, 2018**

## ABSTRAKTI

Tema e disertacionit të doktoratës *Diplomacia ndërkombëtare dhe çështja e Kosovës 1997/1999* trajton një ndër periudhat më të ndjeshme të historisë më të re të Kosovës. Këtu elaborohen edhe një mori çështjesh studimore të cilat problemin e Kosovës e trajtojnë nga këndvështrimi i diplomacisë së fuqive me të mëdha ndërkombëtare të kohës, por që çështja kryesore natyrisht i dedikohet ngjarjeve që zhvillohen në Kosovë dhe rreth saj me përqendrim të veçantë studimi në periudhën e zhvillimeve trevjeçare, përkatësisht gjatë viteve 1997-1999. Reflektimi i këtyre ngjarjeve të këtyre viteve ka rezultuar me ndërhyrjen ndërkombëtare të NATO-së në Kosovë, fillimisht në mënyrë diplomatike e më pas, kur bota demokratike, SHBA-të dhe aleatët e tyre në NATO u bindën se nuk gjendej zgjidhje paqësore, se Serbia nuk e njihte gjuhën diplomatike dhe negociatat, morën vendim për intervenim ushtarak të forcave të NATO-së.

Punimi e ndjek aspektin kronologjik të zhvillimit të ngjarjeve dhe, sigurisht, për shkak të argumentimit të tezave dhe hipotezave shpesh tejkalohej paksa korniza kohore që përcaktohet më vetë titullin e temës. Protestat e studentëve të Universitetit të Prishtinës (1 tetor 1997), dalja në skenë e UÇK-së dhe lufta e saj, Konferenca e Rambujesë, bombardimet e NATO-s mbi caqet ushtarake serbe dhe Marrëveshja e Kumanovës, që shënoi përfundimin e luftës në Kosovës, janë ngjarje dhe zhvillime me këndvështrim të veçantë në planin e hulumtimit dhe trajtimit shkencor.

Sigurisht që qasja e diplomacisë ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës përben madje thelbin e këtij studimi. Pikërisht në këtë dritë trajtohet qasja e diplomacisë ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës në kapituj e nënkapituj, të ndarë sipas profilizimeve të vendeve të ndryshme dhe mbështetur në analizën e fakteve dhe burimeve dokumentare në interpretimin dhe konkluzione.

Studimet bashkëkohore të lëmenjve politikologjike, të marrëdhënieve ndërkombëtare, të së drejtës ndërkombëtare dhe jo vetëm studimet historike të proveniencës euro-perëndimore dëshmojnë e qartësojnë tri këndvështrime, trajtime e qasje të diplomacisë ndërkombëtare lidhur me çështjen e Kosovës, si para luftës, ashtu edhe gjatë luftës në

Kosovë (1998 -1999). Në fakt janë tri politika ndërkombëtare të cilat çështjen e Kosovës e kanë parë nga aspekte të ndryshme, qoftë duke e mbështetur plotësisht (SHBA-ja dhe Britania e Madhe), qoftë duke hezituuar për mbështetje (Evropa Perëndimore) apo duke e kundërshtuar zgjidhjen e çështjes së Kosovës (Rusia) dhe pikërisht këto çasje përbejnë problematiken boshte te temës te shoqëruar me analiza dhe konkludime.

Them se kjo temë paraqet risi në trajtimin e çasjes diplomatike të vendeve të ndryshme të botës, sidomos në rrafshin e standardeve të së drejtës ndërkombëtare, të së drejtës së popujve për të vendosur për fatin e tyre, si dhe të detyrimit që shtetet demokratike, KS i OKB-së, BE-ja dhe NATO-ja duhej të mbanin qëndrim ndaj zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës. Mbështetur në hulumtimin e literaturës lidhur me temën e këtij disertacioni të doktoratës, mbështetur në studimin e thellë dhe analitik të asaj literature, të atyre burimeve arkivore, marr të drejtën të them se një çasje e këtillë, si në këtë studim, deri tash nuk është bërë në historiografinë shqiptare. Ky pohim, pa modesti të shtirur, qëndron në këmbë të forta falë fatit, në njërën anë, dhe këmbënguljes sime, në anën tjetër, për të frekuentuar arkivat e rralla dhe për të qëmtuar ngeshëm të dhënat. Për sa më është e njohur mua një gjë e këtillë nuk është bërë as në studime të tjera që përfshijnë rrafshin e mendimit tonë akademik nacional.

Ndonëse çështjet të cilat do t'i trajtojë në këtë punim ende nuk janë trajtuar në aspektin e duhur shkencor, pos në aspektin publicistik, konsideroj se edhe në këtë plan kjo temë, përkatësisht ky punim, paraqet risi për historiografinë shqiptare, për studimet politikologjike, juridike e veçmas për studimet në fushën e teorisë së marrëdhënieve ndërkombëtare. Megjithatë puna ime mbetet te vlerësohet nga bota akademike, andaj çdo sugjerim apo vërejtje është e mirëpritur nga ana ime.

## **FJALËT ÇELËS**

*Kosova, diplomacia, lufta, shqiptarët, serbët, OKB, SHBA, NATO, Bashkimi Evropian, Shqipëria, Serbia, Rusia, bombardimet, ushtria etj.*

## **ABSTRACT**

The thesis of doctoral dissertation International Diplomacy and Kosovo Issue 1997/1999 addresses one of the most sensitive periods of Kosovo's newest history. Here are also elaborated a number of study issues that the Kosovo problem addresses from the point of view of the diplomacy of the greatest international powers of the time, but the main issue is, of course, dedicated to the events taking place in Kosovo and around it with a particular focus on the period of three years of development, respectively during 1997-1999. The reflection of the events of these years resulted in NATO's international intervention in Kosovo, initially diplomatically and later, when the democratic world, the US and their allies in NATO were convinced that there was no peaceful solution, and that Serbia did not recognize diplomatic language and negotiations, made a decision on military intervention of NATO forces.

The thesis will follow the chronological aspect of the development of the events and, of course, because of the argumentation of the thesis and the hypothesis, it often overcomes a little bit the time frame defined by the title itself of the topic. Student's protests of the University of Pristina (October 1, 1997), the appearance of the KLA and its war, the Rambouillet Conference, the NATO bombing of Serbian military targets and the Kumanovo Agreement, which marked the end of the war in Kosovo, are events and developments with a special focus on research and scientific research.

Certainly, the international diplomatic approach to the Kosovo issue cannot be put aside. It even becomes the core of this study. Exactly in this spot the approach of international diplomacy to the Kosovo issue is seen in chapters and sub-chapters, divided by the profiles of different countries, supported by factual analyses and documentations sources on interpretation and conclusions.

Contemporary studies of political topics, international relations, international law and not just historical studies of the Western European origin prove and clarify three perspective, approaches and accesses to international diplomacy regarding the issue of Kosovo both before and during the war in

Kosovo (1998-1999). Indeed, there are three international policies that have viewed Kosovo's issue from different aspects, whether by fully supporting it (the United States and Great Britain), either by hesitating to support (Western Europe) or by opposing the solution of the issue (Russia) and precisely these cases are the problematic themes of the topic combined with analyzes and conclusions.

I say that this topic is a novelty in dealing with the diplomatic approach of different countries of the world, especially in the area of international law standards, the right of nations to decide for their fate and the obligation that democratic states, KS UN, NATO and the EU had to persist for a fair solution to the Kosovo issue. Based on the literature research on the subject of this PhD dissertation, based on the deep and analytical study of that literature, of those archival sources, I have the right to say that such an approach, as in this study, so far is not made in Albanian historiography. This assertion, without modesty, stands strong on the one hand, and my persistence, on the other hand, to visit frequently the rare archives and to keep track of the data. As far as it is known to me, such a thing has not been done in any other study involving the field of our national academic opinion.

Although the issues that will be addressed in this paper have not yet been addressed in the proper scientific aspect, except in the aspect of publicity, I consider that in this plan this topic, respectively this paper presents novelties for Albanian historiography, for political studies, laws and especially for studies in the field of international relations theory. However, my work remains to be assessed by the academic world, and any suggestion or feedback is welcome from my side.

## **KEY WORDS**

Kosovo, Diplomacy, War, Albanians, Serbs, UN, US, NATO, European Union, Albania, Serbia, Russia, bombing, Army etc.